UDHËZIM
Nr. 180, datë 19.9.2024

PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE DHE PROCEDURAVE PËR REGJISTRIMIN E FËMIJËVE QË LINDIN TË VDEKUR

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, pikës 3, të nenit 15, të ligjit nr. 56/2024, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 129, datë 11.5.2009, 'Për gjendjen civile'", i ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Të paktën njëri nga prindërit dhe në pamundësi të tyre pjesëtarët madhorë të familjes, përfaqësuesit ligjorë ose kujdestarët në rastet kur plotësohen parashikimet e legjislacionit, për shërbimin publik të varrimit në Republikën e Shqipërisë, për fëmijën e lindur të vdekur dhe fetusin e vdekur gjatë lindjes, kanë të drejtë të aplikojnë pranë shërbimit të gjendjes civile për "Leje varrimi për fëmijën e lindur të vdekur".

2. Kërkesa për leje varrimi nga personat e përmendur në pikën 1 (një) të këtij udhëzimi, për fëmijën e lindur të vdekur dhe fetusin e vdekur gjatë lindjes, paraqitet në zyrat e gjendjes civile në bashki/njësi administrative me dokumentin "Certifikatë asistence në lindje", në të cilën përcaktohet që fëmija është lindur i vdekur.

3. Zyrat e gjendjes civile në bashki/njësi administrative në këtë rast nuk do të mbajnë akt lindje dhe akt vdekje për fëmijën e lindur të vdekur dhe fetusin e vdekur gjatë lindjes, por do të lëshojnë dokumentin "Leje varrimi për fëmijën e lindur të vdekur", sipas modelit në aneksin 1, të këtij udhëzimi.

4. Dokumenti "Leje varrimi për fëmijën e lindur të vdekur", nga zyrat e gjendjes civile në bashki/njësi administrative, do të plotësohet me të dhënat mbi bazën e dokumentit të paraqitur "Certifikatë asistence në lindje".

Zyrat e gjendjes civile në bashki/njësi administrative, me plotësimin e të dhënave do të lëshojnë dokumentin "Leje varrimi për fëmijën e lindur të vdekur", për kryerjen e procedurave të mëtejshme të varrimit.

5. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen zyrat e gjendjes civile në bashki/njësi administrative, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile dhe Ministria e Brendshme.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM
Ervin Hoxha

ANEKS NR. 1

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Bashkia_____
Njësia administrative _____
Zyra e Gjendjes Civile _____

LEJE VARRIMI PËR FËMIJËN E LINDUR TË VDEKUR

Shtetasi/shtetësja _____,me nr. personal_____, i cili paraqitet me dokumentin "Çertifikatë asistence në lindje" me nr._____, ku deklarohet që fëmija ka lindur i vdekur.

Lejohet kryerja e varrimit pas orës _____ , më datë __/___/ _____.

Nëpunësi i Zyrës së Gjendjes Civile

_____
(Emri Mbiemri, Nënshkrimi, Vula)